



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A.nr. 149/2013

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Nehat Idrizi kryesues, Nenad Lazić dhe Rafet Haxhaj anëtarë, duke vendosur përkitazi për kërkesën e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), dega në Ferizaj, në seancën e panelit të mbajtur me 05.10.2013, mori këtë:

### V E N D I M

**Konstatohet e tërhequr ankesa** Anr. 149/2013 e datës 03.10.2013 e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), dega në Ferizaj.

### Arsyetim

PZAP-i me datë 05.10.2013 ka pranuar një kërkesë për tërheqje të ankesës Anr.149 nga subjekti politik PDK-së me të cilën kërkohet që mos të shqyrtohet ankesa e lartcekur, me arsyetimin se personat të cilët i kanë vendosur posterat nuk kanë qenë nga rradhët e subjektit politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK).

PZAP-i, pasi që shqyrtoi kërkesën për tërheqjen e ankesës Anr. 149/2013, me të cilën kërkohet nga PZAP-i që mos ta shqyrtoj ankesën në fjalë, në kuptim të nenit 115.1 të LZP-së, PZAP-i vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

### Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

A nr. 149/2013 më datën 05.10.2013

Kryesuesi i Panelit  
**Nehat Idrizi**